



**REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI BASHKIAK  
LUSHNJE**

---

**PROJEKT-VENDIM  
Nr \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_ 2014**

**“PËR SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE. ADMINISTRIMIN E TYRE  
NË QYTETIN E LUSHNJËS DHE PENALITETET PËR KUNDËRVAJTJET  
ADMINISTRATIVE PER VITIN 2015”**

Këshilli i Bashkisë Lushnjë në mbledhjen e tij të datës së \_\_\_/\_\_\_/2014, bazuar në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar ; Ligji Nr. 181/2013, date 28.12.2013; Ligj Nr. 85/2014, date 17.07.2014; Ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar neni 32/f; Ligjin nr 9920 datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ; Udhëzimin e Ministrit të Financave nr 24 datë 02.09.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; ligjit nr. . 107/2014, date 31.07.2014, “ Për Planifikimin e Territorit” ; ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”; ligjit nr. 8450, datë 18.03.1999 “Për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre”; Ligjit nr.9723 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, i ndryshuar; Ligjit Nr.8378 dt 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës se Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjit nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe te gjitha akteve te tjera nenligjore per zbatimin e ligjeve te sipercituara, me propozim te Kryetarit te Bashkise Keshilli Bashkiak,

**VENDOSI :**

I-Të miratojë nivelet e taksave dhe tarifave vendore te Bashkise Lushnje per vitin 2015 si më poshtë:

**1. TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL**

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin vogël.

Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to, të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim :

**1. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 2 (dy) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 7,5%(shtatë presje pesë) për qind, por jo më pak se 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në vit.**

**2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 2 (dy) milionë lekë është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në vit.**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, vepron si agjent tatimor, i ngarkuar me mbledhjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata tatimore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të komunave, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar taksat.

Administrata tatimore, për shërbimin që kryen si agjent tatimor, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të administratës tatimore. Komisioni si agjent tatimor kalon në llogari të buxhetit të shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore dhe për mbulimin e kostove të "Pullave të tatimit".

## **1. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.**

Në taksën mbi pasurinë e paluajtshme perfshihen:

- **Taksa mbi ndërtesën**
- **Taksa mbi tokën bujqësore.**

### **1.a Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor.**

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi dhe në rastin e mungesës së dokumentacionit, Këshilli i Bashkisë ngrë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme i cili verifikon madhësinë e sipërfaqes së tatueshme. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore njeh si dokumentacion një nga dokumentacionet e mëposhteme :

- a) vërtetimin e pronësisë
- b) vendimet e komisionit të kthimit të pronave
- c) vendimet e privatizimit
- d) vetëdeklarimin e ndërtimit pa leje, të shoqëruar me genplan nga një inxhinier i licensuar.
- e) vendimet e komisionit të verifikimit të pasurive të paluajtshme.
- f) Kontrate qeraje brenda afateve të vlefshmerise se saj.

Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, këshilli i bashkisë ose komunës vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme.

Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë ose komunës.

Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e së drejtës së pronësisë. Baza e kësaj takse është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi e taksapaguesit përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë këtë pronësi. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi ndërtesën janë si vijon :

Kategoritë dhe nënkategoritë	Lekë/m <sup>2</sup> /vit
<b>I. NDËRTESA BANIMI*</b>	
<i>Ndërtuar para 1993 – shit</i>	
Ndërtesa banimi	10
<i>Ndërtua pas 1993 – shit</i>	
Ndërtesa banimi	12
<b>II. NDËRTESA TE TJERA</b>	
<i>Ndërtesa për tregti dhe shërbime</i>	
- Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj te ngjashme me to	300
- Ndërtesa prodhimi	60
- Te tjera	60

*\*. Tatimpaguesit që kanë në pronësi më shumë se një banesë, për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm paguajnë taksën e ndërtesës, taksa e ndërtesës është sa dyfishi i taksës së ndërtesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndërtesë.”*

Në nënkategorinë II Ndërtesa përfshihen:

– *Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj të ngjashme me to:*

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat (hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familje, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, bankat, zyrat, njësi tregtare dhe shërbimi të cdo lloji sheshe parkimi dhe lodrash për fëmijë etj.)

– *Ndërtesa për shërbime shëndetsore, artizanale, social kulturore, arsimore e shkencore.*

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat (farmaci, klinika, spitale, maternitete, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve dhe njësitë e shërbimit artizanal si marangoz, këpucar, orëndreqës, etj të ngjashme me to). Shkollat, kopshtet, cerdhe, qendra kulturore, qendra sociale, stadume, komplekse sportive si palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura, ndërtesa shkencore si institute kërkimore, qendra kërkimore, interneti, sallat e koncerteve, videoteka etj.

– *Ndërtesa prodhimi*

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapacierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, naftë etj, shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

– *Ndërtesa të tjera*

Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat të cilat nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme.

– *Ndërtesa të tjera*

Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve:

- Do të përfshihen pronat të cilat përdoren nga organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasadat të njohura ose të rregjistruara si të tilla në gjykatë.

- Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet

Do të kuptojmë të gjithë objektet të cilat janë kapital i Ndërmarrjeve Shtetërore dhe kanë qënë kapital i ish-ndërmarrjeve shtetëror:

⇒ Kur është objekt i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese të cilat janë tërësisht të amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.

⇒ Kur ka qënë objekt i ish-ndërmarrjeve shtetërore të cilat janë privatizuar (tërësisht ose pjesërisht Ndërmarrja ose vetë objekti) dhe është tërësisht i amortizuar (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.

*Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve tregëtare, Taksa e Pasurisë për llogaritjet dhe paguhet si Kategoria II “Ndërtesa për ushtrim aktiviteti me qëllim përfitimi”, për atë pjesë të sipërfaqes së ndërtesës në të cilën ushtrohet veprimtaria tregëtare, duke u përjashtuar nga Kategoria I “Ndërtesa Banimi”.*

#### Afatet e pageses

• Per kategorine II “Ndertesat te tjera” dhe kategorine III “Te tjera” :

- Per sipërfaqe < 2,000 m<sup>2</sup> detyrimi paguhet me nje kest te vetem, brenda dates 20 Prill.

- Per sipërfaqe ≥ 2,000 m<sup>2</sup> detyrimi paguhet me dy keste te barabarta. Kesti i pare paguhet brenda dates 20 Prill dhe kesti i dyte paguhet brenda dates 20 Korrik.

• Nese subjekti taksapagues rregjistrohet rishitaz, pezullon veprimtarine ose aplikon per cregjistrim prane Q.K.R-se gjate vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumezuar nivelin e taksës per vitin e plote kalendarik me numrin e muajve te plote gjate te cileve veprimtaria eshte kryer (perfshire muajin korrent per te cilin eshte bere aplikimi per rregjistrim, pezullim ose cregjistrim) dhe duke e pjesetuar ate me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

#### Lehtesirat tatimore

• Perjashtohen nga pagimi i taksës mbi ndërtesat :

a. Taksapaguesit, per kategorine I “Ndertesat banimi” dhe qe i perkasin kategorise “Invalid te punes dhe te luftes, te verber, veterane te luftes, si dhe te semure para dhe tetraplegjike.” Kjo zbatohet kur asnje person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.

b. Pronat e shtetit dhe te njesive te qeverisjes vendore, qe perdoren per qellime jofitimprurëse,

c. Ndertesat e banimit, qe shfrytezohen nga qiramarrës me qira te paliberalizuara,

d. Ndertesat qe perdoren nga komunitetet fetare.

#### 2.b Taksa mbi tokën bujqësore.

Taksa mbi tokën bujqësore është detyrim vjetor. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës në hektarë, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumentave që e vërtetojnë atë. Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës Bujqësore	Vlera e taksës në lekë/hektar/vit
I	5000
II	4200
III	4000
IV	3000
V	2500

#### Lehtesirat tatimore

• Perjashtohen nga pagimi i taksës mbi token bujqësore :

- Taksapaguesit që i perkasin kategorise “Invalid te punes dhe te luftes, te verber, veterane te luftes, si dhe te semure para dhe tetraplegjike.” **Kjo zbatohet kur asnje person nga familja nuk merret me aktivitet biznesi.**
- Siperfaqet e tokes bujqësore qe mbillen me kultura drufutore dhe vreshtari per pese vitet e para nga çasti i mbjelljes (e konfirmuar nga Drejtoria Rajonale e Bujqesise dhe Ushqimit Lushnjë).

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën dhe taksën mbi tokën bujqësore është Zyra e Kadastres dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lushnjë.**

### 3. TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Niveli i taksës është **5 %** e çmimit të fjetjes për person ose për dhomë, për një natë. Me **“hotel”** kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejtë pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim.

1.Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia me çmimin e fjetjes dhe numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

2.Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë ose të komunës, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

3.Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lushnjë.**

#### Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja.

Baza e taksës është vlera në leke e investimit të ri që do të kërkojë të kryhet. Si vlerë investimi do të merret kosto e ndertimit /m<sup>2</sup> e percaktuar me V.K.M në fuqi. Klasifikimi si investim i ri percaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhenien e lejeve të ndertimit .

Niveli i taksës sipas zonave:

#### ZONA “A” ME RRJET INXHINIERIK TE KONSOLIDUAR

-Per banesat kolektive dhe objektet qe nuk perfshihen ne kategorite e tjera, **niveli taksës 3%**

-Per objektet administrative dhe sherbimi **niveli taksës 3%**

-Per objekte per qellime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale private, **niveli taksës është 3%.**

-Per ndertimet ne infrastrukture si rruge, ujesjelles, kanalizime, ndricim public, telefon (te gjitha keto publike), **niveli taksës është 0%.**

-Per banesat individuale **niveli taksës është 2.5%.**

#### Zona “B” ME RREJT INXHINIERIK TE PAKONSOLIDUAR

-Per banesat kolektive dhe objektet qe nuk perfshihen ne kategorite e tjera, **niveli takses 2 %**.

-Per objektet administrative dhe sherbimi,**niveli takses 2.5%**.

-Per objekte per qellime publike si kopshte, çerdhe, shkolla, spitale private, **niveli takses eshte 2%**.

-Per ndertimet ne infrastrukture si rruge ujesjelles,kanalizime,ndricim public,telefon(te gjitha keto publike),**niveli takses eshte 0%**

-Per banesat individuale **niveli takses eshte 2% -**

- Leje per vendosje antenash/konstruksione metalike, per trasmetimin e valeve per operatore pa fuqi te ndjeshme ne treg/ te frekuencave me burime te kufizuara, **niveli takses eshte 3%**

*Ne mungese te akteve nenligjore nuk mund ta parashikojme . e propozuar 0%.*

-Leje per vendosje reklamash apo promocioni nga institucione private dhe publike, **niveli takses eshte 3% -**

*Ne mungese te akteve nenligjore nuk mund ta parashikojme e propozuar 0%.*

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, taksës nga ndërtimet e reja për studime projektive dhe vjeljen e tyre, është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit pranë Bashkisë Lushnjë.

## **5. TAKSA E KALIMIT TË SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURIT E PALUAJTSHME**

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitje s së tyre.

**Agjenti Tatimor për vjeljen e kësaj takse është Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Lushnjë, e cila përfitonë 3 % të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhit për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë ose të komunës, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.**

## **6. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.**

Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qendrore dhe njërive të qeverisjes vendore. Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njërive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin (komunë, bashki) të taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit. Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 (pesë)% të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 18 (tetëmbëdhjetë)% të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore, dhe 82 (tetëdhjetë e dy)% të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj). Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qendrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrimit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.



## 7.TAKSA PËR ZËNIEN E HAPËSIRAVE PUBLIKE.

Baza e taksës për zënie e hapësirave publike është sipërfaqja në metër katror (m<sup>2</sup>) e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim mujor i taksa paguesit duke shumëzuar bazën e taksës (sipërfaqen) me nivelin tregues të saj.

**Niveli i kësaj takse për Bashkinë Lushnjë është 90 Lekë/m<sup>2</sup>/muaj muaj.** Ndalohet zënia e hapësirave publike ( trotuare, sheshe etj) të cilat nuk janë të miratuara nga Bashkia Lushnjë.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës për zënie e hapësirave publike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit pranë Bashkisë Lushnjë e cila jpe leje per zenien e hapsires publike.**

## 8.TAKSA E TABELËS DHE REKLAMËS.

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emrin/emërtimin e subjektit në njësinë ku zhvillojnë veprimtarinë .

Vendosja e tabelës me emrin dhe tregues të aktivitetit është e detyrueshme për të gjithë subjektet me përjashtim të ambulanteve, subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e transportit dhe tregtareve që ushtrojnë aktivitet ne tregjet e miratuara.

Niveli i takses se tabelës sipas kategorive perkatëse percaktohet sipas tabelës se mëposhtme :

Kategoritë	Niveli i taksës
Tabelë për qëllime identifikimi, pavarësisht nga sipërfaqja, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	120 lekë/vit
Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	120 lekë/vit
Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.	1.000 lekë/m <sup>2</sup> /ditë
<b>TAKSË REKLAME</b> - E thjeshtë dhe elektronike	13.500 lekë/m <sup>2</sup> /vit deri në sipërfaqen 18 m <sup>2</sup> . Për sipërfaqemë të mëdha se 18 m <sup>2</sup> paguhet 243.000 lekë/vit

### Sqarime

- Per kategorine I **“Tabele per qellime identifikimi”**, vendosja e tabelës per qellim identifikimi eshte detyrim per te gjithe subjektet tregtare.
- Per kategorine II **“Tabele per qellime reklamimi, te thjeshta dhe elektronike”**, per vendosjen e saj cdo subjekt duhet te kryej keto procedura :
  1. Paraqitja e kërkesës me shkrim pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
  2. Paraqitja e planvendosjes.
  3. Marrja e miratimit nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit
  4. Pagesa e lejes per vendosjen e reklames
  5. Lidhja e kontrates dhe pagesa e takses per qellime reklamimi
- Per kategorine III **“Tabele ne funksion te ekspozimeve te ndryshme te hapura (Panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj)”**, detyrimi per taksen e tabelës llogaritet sipas diteve te percaktuara ne lejen perkatëse te leshuar nga strukturat perkatëse te Bashkisë Lushnjë.

### Afatet e pageses

- Taksa e tabelës paguhet per cdo adrese (kryesore dhe dytesore) ku subjekti zhvillon aktivitetin, si dhe per cdo table te vendosur.
- Detyrimi per taksen e tabelës paguhet me nje kest te vetem, i cili paguhet brenda dates 20 Prill. Per subjektet te cilat detyrimi i lind pas dates 1 prill eshte 30 dite pas lindjes se detyrimit.
- Nese subjekti taksapagues regjistrohet rishtaz, pezullon veprimtarine ose aplikon per cregjistrim pranë Q.K.R-se gjate vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumezuar nivelin e takses per vitin e plote kalendarik me numrin e muajve te plote gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshire muajin korrent për të cilin është bërë aplikimi për rregjistrim, pezullim ose cregjistrim) dhe duke e pjesetuar ate me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse per piken 1 është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse per piken 2 dhe 3 është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit e cila jep dhe lejet per vendosjen e ketyre tabelave.

Kjo leje te mos jepet pa aprovimin dypalesh te Drejtorise se Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Drejtorise se Planifikimit dhe Kontrollit te Territorit.

## 9. DHËNIE AUTORIZIMI PËR PIKAT E TREGËTIMIT ME PAKICË TË KARBURANTEVE DHE NJËSITË E SHITJES SË LËNDËVE DJEGËSE DHE BOMBOLAVE TË GAZIT

Bazuar në Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 “për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 “për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 “për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 129, datë 18.03.1999 “për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre” të ndryshuar me Vendimet e Këshillit Ministrave Nr. 170, datë 25.04.2002 & Nr. 563, datë 27.08.2004 “për disa shtesa dhe Ndryshime për procedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të Nënprodukteve të tyre”, Bashkia Lushnjë jep autorizime për personat juridikë apo fizikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Lushnjë. Pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon :

Nr	Emertimi	Njesia	Tarifa neLeke
1	Autorizim per funksionimin si stacion shitje te karburanteve,gazi te lengshem te naftes dhe vajrave lubrifikant	Per autorizim	100.000
2	Pagesë për dhënie autorizimi për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit të lëngshëm të naftës	Per autorizim	50.000

**Shenim:** Per dublikate me te njeiten permbajtje dhe afat vlefshmerie paguhet 30% e vleres se plote.

Per perseritjen periodike te autorizimit tarifa e pageses eshte 50% e vleres se autorizimit fillestar.

Struktura e ngarkuar për dhënien e këtij autorizimi është Drejtoria e Shërbimeve Publike pranë Bashkisë Lushnjë.

### B. TARIFAT VENDORE

#### B.1 TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TE MBETURINAVE

Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lushnje, ne çdo njësi ku ushtrojnë aktivitetin.

Pagesa për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave është detyrim vjetor.

Për Kategorinë “ Biznesi ” detyrimi paguhet brenda datës 20 Prill të vitit. Kur detyrimi lind 6/mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50 % të detyrimit. Afati i pageses per detyrimet e lindura pas dates 1 Prill eshte 30 dite pas lindjes se detyrimit.

Nr.	Aktiviteti	Niveli i Tarifes leke/vit	Niveli i Tarifes leke/vit
-----	------------	------------------------------	------------------------------



		Biznesi i Vogel	Biznesi i Madh
<b>I</b>	<b>Kategoria Biznes</b>		
<b>1</b>	<b>Subjekte te reja te cilat hapen gjate vitit 2015*</b>	5000	-
<b>2</b>	<b>Shitje me pakice/shumice(TREGTI)</b>	-	40000
	Bulmet,mish,peshk	15000	-
	Fruta perime,ushqimore	10000	-
	Artikuj industriale(veshje,parfumeri,argjendari etj)	10000	-
	Pub,diskoteka,lojera fati	20000	-
	Bar,Fast food,kafe internet etj	10000	-
	Bar restorant,hotel,motel,komplekse turistike,pensione	10000	-
<b>3</b>	<b>Prodhim</b>	-	
	Subjekte qe ushtrojne aktivitet ne fushen e prodhimit	20000	70000
<b>4</b>	<b>Ndertim</b>	-	-
	Subjekte ndertuese per seline administrative	-	10 000
	Subjekte ndertuese per cdo kantier ndertimi	-	70 000
<b>5</b>	<b>Sherbim</b>	10000	40000
<b>6</b>	<b>Profesione te lira</b>	10000	-
<b>7</b>	<b>Institucione Buxhetore</b>	-	40000
<b>8</b>	<b>Sherbimi i transportit</b>	-	-
	<b>Transport mallrash</b>	-	-
	<b>a.Furgona</b>	6000	40000
	<b>b.Kamiona</b>	10000	40000
	<b>Transport udhetaresh</b>	-	40000
	<b>a.Taxi 4+1</b>	5000	-
	<b>b.Taxi 8+1</b>	10000	-
	<b>c.Minibuza</b>	12000	-
	<b>d.Autobuza</b>	15000	-
<b>9</b>	<b>OJF dhe Institucionet fetare</b>	-	20000
<b>10</b>	<b>Bankat</b>	-	50000

-Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarifës së Pastrimit dhe Largimit të Mbeturinave është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

- Per Bizneset me xhiro 0 deri ne 2 milion Tarifa e Sherbimit Komunitar (pastrim, gjelberim, ndricim) te jete 3.500 leke

Tarife per depozitim e mbetjeve te ngurta eshte 20 leke/ m2.

\*5000 leke eshte vlere qe subjekti do te paguaje ne totale per tarifen e sherbimit komunitar.

Të ardhurat e krijuara nga kjo tarife, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarife.

### **TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TE MBETURINAVE**

<b>Ndertim</b>		
Per cdo leje ndertimi deri ne 5-kt*	-	70.000
Per cdo leje ndertimi mbi 5-kt *	-	100.000

*\* Per cdo leje ndertimi deri 5-kt dhe mbi 5-kt dhe subjekte ndertuese per seline administrative e ngarkuar per mbledhjen e Tarifes se Pastrimit dhe Largimit te Mbeturinave eshte Drejtoria e Planifikimit te Territorit, tarife qe duhet ta mbledhi para zbardhjes se Lejes se Ndertimit.*

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e Tarif per depozitim e mbetjeve te ngurta është Drejtoria e Planifikimit te Territorit.

## **B.2 TARIFA E NDRIÇIMIT**

Objekt i kësaj tarife do te jene të gjithë familjaret, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Lushnjes. Kjo takse paguhet për çdo njësi ku ushtron aktivitetin subjekti.

Subjekte Biznes i Vogel.....2000 leke

Subjekte Biznes i Madh.....5000 leke

Institucionet Buxhetore.....3000 leke

Detyrimi për taksën e ndriçimit është vjetor.

Detyrimet paguhen brenda datës 20 Prill të vitit fiskal. Kur detyrimi lind 6 mujorin e dytë të vitit, subjektet paguajnë 50% të detyrimit. Afati i pageses per detyrimet e lindura pas dates 1 Prill eshte 30 dite pas lindjes se detyrimit.

Të ardhurat e krijuara nga kjo tarife, përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është vendosur kjo tarife.

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ne Bashkinë Lushnje.**

## **B.3 TARIFA E GJELBERIMIT PUBLIK**

Tarifës së gjelbërimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Lushnjes. Kjo takse paguhet për çdo njësi ku ushtron aktivitetin subjekti.

